



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 4670 Prot

Tiranë, më 27.7.2018

Nr. 667 Dosje

URDHËR

PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar:

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Unë, Julian Ahmeti, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbardimit Privat “E.P.S.A” SHPK, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 9577 Akti të lëshuar më datë 25.09.2012 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore kërkesën e kreditorit “Raiffeisen Bank” SHA ndaj debitorit Shoqëria “A-Group” SHPK, Shoqëria “Media 99” SHA, Shoqëria “Alb Golem” SHPK, Arben Ismailaga si edhe ndaj dorëzanësit (debitor) Arben Ismailaga, Ilir Gjuzi në lidhje me titullin ekzekutiv “Kontratë Kredie Bankare Nr. 5594 Rep. Nr. 2027 Kol. datë 06.11.2010”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 9577 Akti të lëshuar më datë 25.09.2012 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile.

KONSTATOVA Se :

Debitorët e mësipërm, kanë marrë njoftimin e Lajmërimin për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorëve në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në kushtet kur mospërmbushja në referim të nenit 527, 560, 563 të K.Pr.Civile dhe nenit 32 pikat (b,c,ç) të ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat”,

KËRKOJ

1- Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të kryejë veprimet për **bllokimin e kuotave/aksioneve dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për debitoret ;**

- 1) **Shoqëria “A-Group” SHPK**, përfaqësuar nga Z. Arben Ismailaga, në cilësinën e Administratorit, me NIPT: K72205014A.
- 2) **Shoqëria “Media 99” SHA**, përfaqësuar nga Z. Arben Ismailaga, në cilësinën e Administratorit, me NIPT: K21817006K.
- 3) **Shoqëria “Alb Golem” SHPK**, përfaqësuar nga Z. Arben Ismailaga, Ilir Gjuzi në cilësinën e Administratorit, me NIPT: K43420801E.
- 4) **Arben Ismailaga** (atësia: Xhavit, datëlindja: 14.10.1960).
- 5) **Ilir Gjuzi** (atësia: Abdyl, datëlindja: 29.04.1962).

të lartpërmendur, deri në një urdhër të dytë nga përmbaruesi gjyqësor.

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II)) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT “E.P.S.A”SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

JULIAN AHMETI

